



DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE

Me datë 04.03.2019

Nr. 575

Në mbështetje të nenit 4 nenit 13, lidhur me nenin 10, 11, të Rregullores MF-NR-04/2017, mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komunën e Suharekës, bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Suharekës, përkatësisht Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, përmes kësaj shkrese ju bën thirrje publike për aplikim të gjitha OJQ-ve, të regjistruara në Republikën e Kosovës dhe që fushëveprimtari kanë shërbimet për persona me nevoja të veçanta, të aplikojnë për mbështetje financiare.

QËLLIMI;

Qëllimi i kësaj thirrje publike është subvencionimi dhe mbështetja financiare për OJQ-të që kanë për qëllim shërbimet e personave me nevoja të veçanta nga fushëveprimtaria e tyre si më poshtë;

- Ofrimi i shërbimeve edukative, sociale dhe zhvillimore për persona me nevoja të veçanta
- Ngritja e kapaciteteve për persona me nevoja të veçanta
- Ofrimi i shërbimeve nga fizioterapia primare
- Ofrimi i shërbimeve nga ergoterapia
- Ofrimi i shërbimeve logopedike
- Edukimi shëndetësor për persona me nevoja të veçanta dhe familjarë të tyre
- Aktivitete rekreative dhe sportive për persona me nevoja të veçanta
- Furnizimi i rasteve me mjete-paisje ortoprotetike

SPECIFIKAT TJERA TË THIRRJES PUBLIKE

- Thirrja publike për aplikim hapet më 04.03.2019 dhe mbyllet më 22.03.2019.
- Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së afatit për aplikim nuk do të pranohen
- Aplikacionet e pa kompletuara sipas kriterëve të përcaktuar në këtë thirrje do të refuzohen
- Zbatimi i projekteve do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DSHMS.
- Mbështetësi financiar, përkatësisht Komuna e Suharekës dhe përfituesi i donacionit do të lidhin kontratë me të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
- Me secilën OJQ që do të jetë përfituese e subvencionit do të nënshkruhet një kontratë përfituesit të mjeteve financiare dhe mbështetësit financiar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen gjatë aplikimit për ndarjen e subvencionit;

- Aplikacioni, (sipas modelit të DSHMS –së); të tërhiqet në DSHMS
- Projekt-propozimi, përfshirë, agjendën, aktivitetet, planifikimi dhe linja buxhetore në harmoni me qëllimin e projektit,
- Licenca për personat Juridike për kryerjen e këtyre shërbimeve
- Kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar nga OJQ-së,
- Certifikata me numër fiskal,
- Certifikata me numër të regjistrimit të biznesit
- Kopja e kartelës së xhirollogaroisë në emrin e OJQ-së dhe kopja e letërnjoftimit të personit të autorizuar.
- Raporti financiar i vitit paraprak 2018 (kjo vlenë vetëm për OJQ-te që kanë pranuar subvencione edhe në vitin e kaluar).
- Deklaratë për mos financim të dyfishtë.

Mënyra e aplikimit;

- Dorëzimi i aplikacionit bëhet në zarf të mbyllur,
- Brenda zarfit vendosen një kopje e të gjitha dokumentacionit origjinal të kërkuara,
- Dokumentacioni dorëzohet në zyrën e pranimi në katin e parë në objektin e Komunës.



Drejtoresha e Drejtorisë


Sale BYTYQI